

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	DPK
Nr. Prot. Br. Prot.	03-03/2406/20
Nr. l. fsh. Broj stranica	03
Nr. pages	
Date Datum	27.10.2020
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	26/10/2020
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-2388/20
PËR/ZA/TO:	z.Burim REÇICA Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Ministrinë e Kulturës RS dhe ÇJK
CC:	z.Iber ALAJ Ud. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës RS dhe ÇJK
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Masat preventive në fushën e trashëgimisë kulturore në katër rajone "



I nderuar z. Reçica,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "**Masat preventive në fushën e trashëgimisë kulturore ne katër rajone**", me numër të prokurimit: 207-20-6766-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: 207-20-101-5-2-1, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: "**Masat preventive në fushën e trashëgimisë kulturore ne katër rajone**", me numër të prokurimit: 207-20-6766-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: 207-20-101-5-2-1, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të

Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 26/10//2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *DPKPP 03-03/2388/20*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Masat preventive në fushën e trashëgimisë kulturore në katër rajone**", me numër të prokurimit: 207-20-6766-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: 207-20-101-5-2-1., i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Kulturës RS dhe ÇJK.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar në shumë prej 416,746.00 €.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka konstatuar se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional Lista e kontratave* është kërkuar si në vijim: Për të gjitha Lotet OE duhet të dëshmoj se ka realizuar **së paku 3 kontrata** gjatë periudhës së shkuar trevjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë në lëmine e ndërtimeve (LOT1 250,000.00 Euro, LOT2 150,000 Euro, Lot 3 55,000 Euro dhe LOT 4 150,000 Euro), restaurim konservim, renovim apo edhe punëve të ngjashme. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Një listë të kontratave të realizuara 3 vjeçare, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës të bashkëngjiten referencat për realizimin me sukses të punëve ose pranimet teknike. ***Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.***

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 4.2 parashihet se: "Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë".

Agjencia konsideron se Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të kontratave dhe referencave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për Autoritetin Kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar



nga ana e Autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të kontratave dhe referencave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i kontratave dhe referencave në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092 dhe nenin 26 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !